

VENDIM
Nr. 99, datë 24.6.2020

**MBI PLOTËSIMIN E KUSHTEVE TË VENDIMIT TË ERE-s NR. 43, DATË 15.3.2017,
“MBI MIRATIMIN PËRFUNDIMTAR TË CERTIFIKIMIT TË OPERATORIT TË
SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE OST SHA, NË
PËRPUTHJE ME NENIN 54, PIKA 6, TË LIGJIT NR. 43/2015, “PËR SEKTORIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE”, TË NDRYSHUAR, DHE ME NENIN 9, PIKA 6, TË
DIREKTIVËS 72/2009 EC, “MBAS MARRJES SË OPINIONIT TË SEKRETARIATIT
TË KOMUNITETIT TË ENERGJISË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 58, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurës administrative”; si dhe nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.6.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 75/4 prot., datë 16.6.2020, të për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a.,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 43, datë 15.3.2017, ka vendosur miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a., në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të nenin 9, pika 6, të direktivës 72/2009 EC.

- ERE, me vendimin e Bordit nr. 207, datë 16.12.2019, ka vendosur:

Të miratojë kërkesën e OST sh.a. për shtyrjen e afatit të zbatimit të pikës 2, të vendimit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a.”, në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë Elektrike”, të ndryshuar dhe me nenin 9, pika 6, të direktivës 72/2009 EC, “Mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”, deri në datën 16.6.2020.

- ERE iu drejtua shoqërisë OST sh.a., me shkresën nr. 736 prot, datë 2.6.2020, duke i kërkuar informacion mbi ecurinë e plotësimit të kushteve të parashikuara në vendimin e ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, afati i plotësimit të të cilave është shtyrë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 16.12.2019.

- Shoqëria OST sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 743 prot., datë 3.6.2020, ka përcjellë informacion në lidhje me përmbushjen e kushteve të parashikuara në vendimin nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a.”, në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe me nenin 9, pika 6, të direktivës 72/2009 EC, “Mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”, të ndryshuar.

- Kushti i paplotësuar, referuar më sipër, ka të bëjë me: “Bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe transferimi i kompetencave te Ministria e Ekonomisë”.

- OST sh.a. bëri me dije. se në ndryshimet e miratuara të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, në datën 14 maj 2020, ndër të tjera janë reflektuar edhe ato që çojnë në plotësimin e këtij kushti.

- Sa më sipër, nga ana e ERE-s është konstatuar se Parlamenti Shqiptar, me ligjin nr. 61/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ka miratuar disa shtesa dhe ndryshime të cilat konstatojnë në: nenin 31, pika 1:

Ishte: “Linjat e reja të interkoneksionit, që ndërtohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit apo nga investitorët privatë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë”.

Bëhet: “Linjat e reja të interkoneksionit, që ndërtohen nga investitorët privatë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë”.

- Pika 8, e nenit 60, me përmbajtje: “ERE, në ushtrimin e kompetencave të parashikuara në pikat 1, 6 dhe 7, të këtij neni, duhet të marrë mendimin nga ministri përgjegjës për energjinë.”, shfuqizohet.

- Me miratimin e ndryshimeve ligjore si më sipër, rezulton se shoqëria OST sh.a., ka plotësuar tërësisht kushtet e parashikuara në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017.

- Referuar kushtit të vendosur në pikën 2, paragrafi i parë, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, OST sh.a., ka detyrimin që çdo vit të paraqesë në ERE informacion mbi pavarësinë e audituesve financiarë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e pikave 2, 3 dhe 4 të vendimit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a., në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe nenin 9, pika 6, të direktivës 72/2009 EC, “Mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”, të ndryshuar.

2. OST sh.a. të paraqesë në ERE çdo vit ushtrimor informacion mbi pavarësinë e audituesve financiarë.

3. Drejtoria e Çështjeve Ligjore t’u njoftojë këtë vendim OST sh.a., Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, Autoritetit të Konkurrencës, si dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti